



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror
Kryesia e Kuvendit
P-042

Prishtinë, më 8 korrik 2022, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 KORRIK 2022

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Blerta Deliu-Kodra, Arben Gashi, Albana Bytyqi dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me pikën për seancën e re plenare:

- *Shqyrtimi i raportit me rekomandime lidhur me Kërkesën për miratimin e buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv rregullator dhe në ndërmarrje publike,*

si dhe me pikat për Kryesinë e Kuvendit:

- *Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Enver Hoxhaj, për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Bratislavë (Sllovaki),*

- *Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për biletat e anuluarat të udhëtimeve në Strasburg, Berlin dhe Hagë.*

* * *

Në fillim, Kryesia e mbajti një minutë heshtje në nderim të ish-kryeministrit të Japonisë, Shinzo Abe, i cili kishte vdekur po atë ditë, më 8 korrik 2022, nga një atentat me armë zjarri. Gjithashtu, kryetari e dënoi aktin e vrasjes së ish-kryeministrit të Japonisë, Shinzo Abe.

* * *

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancën e re plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 13, 20 qershor dhe 1 korrik 2022.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Kryesia, pas diskutimeve vendosi që vazhdimet e tri (3) seancave plenare me pikat e papërfunduara të mbahet të enjten, më 14 korrik 2022, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 22, 23 qershor, 1 dhe 6 korrik 2022:

19. *Shqyrtimi i raportit vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021,*
20. *Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021.*

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 qershor, 1 dhe 6 korrik 2022:

6. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave,*
7. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2021.*

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7 korrik 2022:

4. *Votimi në lexim të dytë i Projekt-kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale,*
5. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-132 për ekzekutimin e sanksioneve penale,*
6. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës,*
7. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës*
8. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.*

Kryesia, me kërkesë të deputetes Albana Bytyqi, në emër të GP të AAK-së, parashtroi i kërkesës për debat parlamentar, vendosi që debati parlamentar në lidhje me mosliberalizimin e vizave nga BE-ja për Kosovën të shtyhet për një seancë tjetër plenare, debat i cili ishte pikë e shtyrë e rendit të ditës të seancës plenare, e mbajtur më 7 korrik 2022.

3. Përgatitjet për seancën e re plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme dhe pas diskutimeve, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet po ashtu të enjten, më 14 korrik 2022, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-150 për ratifikimin e Traktatit mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-103 për Sistemin e menaxhimit të performansës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performansë,*
5. *Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv rregullator dhe në ndërmarrje publike.*

Po ashtu, në lidhje me pikën nr. 5 të lartshënuar të rendit të ditës të seancës plenare, kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, ka propozuar që kompensimi i anëtarit të Komisionit Hetimor Parlamentar për funksion dhe për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit hetimor të bëhet sipas Vendimit nr. 04-V-079, të datës 10 tetor 2011, për caktimin e lartësisë së kompensimit të deputetit për funksion udhëheqës dhe kompensimin e shpenzimeve mujore, që nënkupton se deputeti kompensohet vetëm për një funksion, e për komision të dytë 80 euro, ndërsa për komisionin e tretë nuk kompensohet.

Pastaj, me propozim të kryetarit, Kryesia vendosi që me rastin e miratimit të buxhetit të këtij Komisioni Hetimor Parlamentar, në vendimin e Kuvendit të shtohet edhe një pikë:

“Ky rregull i kompensimit të zbatohet edhe për komisionin tjetër hetimor në lidhje më menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i formuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 08-V-280, datë 5 maj 2022, të cilit Kuvendit ia ka martuar buxhetin më 23 qershor 2022”.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Emërimi i kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Ukrainës

Kryesia, në lidhje me Grupin e Miqësisë të lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Ukrainës

I. Emërohet kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Ukrainës, i formuar me Vendimin nr. 08-V-228, datë 20. 6. 2022.

1. Saranda Bogujevci, kryetare, nga GP i LVV-së,
2. Xhavit Haliti, nënkryetar, nga GP i PDK-së,
3. Blerta Deliu-Kodra, anëtare, nga GP i PDK-së,
4. Pal Lekaj, anëtar, nga GP i AAK-së,
5. Enis Kervan, anëtar, nga GP Multietnik.

II. Propozimet eventuale të grupeve parlamentare për zëvendësimet dhe plotësimet e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Grupit të Miqësisë nga pika një (I) e këtij vendimi i dërgohen Drejtorisë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Administratës së Kuvendit për përditësimin e përbërjes së Grupit të Miqësisë.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktima të Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione që Qeveria e Republikës së Kosovës ta hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkesa që Qeveria e Republikës së Kosovës ta hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi i kthehet Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktima të Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione.

2. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktima të Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi dhe pastaj bazuar në të gjeturat gjatë mbikëqyrjes së tij të procedojë rekomandimin eventual për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Tern (Itali)

Kryesia përsëri nuk vendosi për kërkesën e deputetit Burim Meta për lejimin e udhëtimit zyrtar në Tern (Itali), prej 30 korrik deri më 4 gusht 2022.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Pragë (Çeki)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rrezarta Krasniqi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Pragë (Çeki), prej 9 deri më 12 korrik 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shtyhet vizita e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë në Shqipëri, që ishte paraparë prej 12 deri më 14 korrik 2022.

6. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Danimarkë dhe në Suedi

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fridon Lala, i mbulohen shpenzimet e biletës së trenit në shumën prej 130 euro për udhëtimin e tij nga Kopenhaga (Danimarkë) për në Stokholm (Suedi), gjatë udhëtimit zyrtar të realizuar në këto dy vende, prej 8 deri më 16 qershor 2022, sipas kërkesës nr. 08/2217/Do-961, datë 5. 7. 2022.

7. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Zagreb (Kroaci)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, i mbulohen mëditjet për dy (2) ditë (datë 23 dhe 24 qershor 2022), për udhëtimin e zyrtar të realizuar në Zagreb (Kroaci), prej 20 deri më 24 qershor 2022, sipas kërkesës nr. 08/2216/Do-960, datë 5. 7. 2022.

8. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Enver Hoxhaj, për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Bratislavë (Sllovaki)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, i mbulohen shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Bratislavë (Sllovaki), prej 1 deri më 4 qershor 2022, sipas kërkesës nr. 08/2238/Do-968, datë 7. 7. 2022.

9. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për biletat e anuluarat të udhëtimeve në Strasburg, Berlin dhe Hagë

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Mbulohen shpenzimet e biletave të aeroplanit të anuluarat në lidhje me udhëtimet zyrtare, si vijon:

- Shuma prej 458,00 euro për biletën e re për deputetin Armend Zemaj në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Berlin (Gjermani), prej 1 deri më 4 qershor 2022.
- Shumat nga 116,06 euro për biletat e reja për secilin nga deputetët: Saranda Bogujevci dhe Enis Kervan për kthim nga Strasburgu për në Prishtinë në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Strasburg (Francë), prej 19 deri më 24 qershor 2022.
- Shuma prej 697,72 euro për biletën e pashfrytëzuar (të anuluar) nga deputetja Albana Bytyqi, e cila nuk e ka realizuar udhëtimin zyrtar në Hagë (Holandë), prej 26 deri më 28 qershor 2022.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

Në fund, kryetari para të pranishmëve e shtroi çështjen e vetingut, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutoi deputetja Blerta Deliu-Kodra, përfaqësuese e GP të PDK-së, diskutimi i së cilës është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 14:23 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale